

## PROCESVERBAL

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pastrim kanalesh + Ushqyes Rezervuari”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

45247111-1 - Punime ndërtimi për kanale ujitëse

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,500,000 (Kater milion e peseqind mije) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Has** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo me vogël se vlera e parashikuar e kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi

**2.2.2** Kopje e vërtetuar të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022) të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet. *ku të paktën në dy bilance të njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

*Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe viti 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), nenin 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

*Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme kerkohen:**

**a Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë sa 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, si dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

**b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është sa dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet..**

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratata e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit, certifikaten e marrjes ne dorezim te perhershem dhe faturat tatimore perkatese me entet publike ose fatura tatimore dhe kontrata bashkepunimit me ente private.*

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë formulari i vleresimit i shoqeruar me: Kontraten e punimeve; Lejen e ndertimit dhe te shfrytezimit leshuar nga njesia vendore perkatese; Situacionin perfundimtar si dhe faturat tatimore per çdo situacion.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 “Procedure e hapur e thjeshtuar”, pika 4 \ a , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik:*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se 15 (Pesëmbëdhjetë) punonjësish, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë 3 (Tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të*

*prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **Drejtues Teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë

**-1(një) inxhinier hidroteknik**

Ing hidroteknik do të merret me kontrollin e cilësisë së punimeve, dhe betonit që do të vendoset në veper. Do të merret me instruktimin e punonjësve në objekt etj.

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë

**- 1 (një) inxhinier topograf**

**- 1 (një) teknik ndërtimi**

te cilet duhet të figurojnë në Listëpagesa të pakten për 3 muajt e fundit, për te cilet duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diploma përkatëse.

Ing.Topograf do të merret me zbatimin e kuotes së punimeve në veper

Tekniku i ndërtimit do të merret direkt me zbatimin e punimeve në veper, do të realizojë librezat e masave të vëllimeve të punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është hartuar mbi bazën e parashikimeve të VKM Nr.42 datë 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas të ciles, “Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/jane përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në rastin konkret, në projekt-preventivin janë parashikuar punimet që do të kryhen dhe për realizimin e tyre janë kërkuar inxhinieret sipas profileve dhe profesioneve përkatëse. Numri i tyre është bërë nisur nga sasitë e punimeve në preventive dhe natyrën e objektit të kësaj kontrate.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (Tre ) punonjës saldator të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve,

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë sipas kodit përkatës të profesionit.
- *Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:*

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat i leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
.....				

**Shoferat per mjetet e transportit 2 ( dy)**

**Manovrator eskavatorist**

**2 (dy)**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
  - (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe referuar Kodit Rrugor.
- **Për manovratorët dhe shoferët të cilet shoqëria i punëson nepermjet kontraktimit (mjetet me qera) punonjesit nuk do te kerkohen ne listepagesat e shoqërisë.**

*Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listepagesat përkatëse të O.E. ofertues.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit (pervec tabelës se mesiperme e cila duhet te paraqitet e plotësuar gjate fazes se ofertimit), sipas Shtojcës 8*

-3 **saldatoret** do te bejne te mundur saldimin e tubit te celikut.

Ky punim do te behet me puntore qe mos te priset struktura e dherave ne bankinen e kanalit ujites dhe do te behet transporti i tyre me auto. Eshte vendosur numri i puntoreve prej 15 personash mbeshtetur ne perlllogaritjen:

Germim dheu ne kanal m3 7260 ore pune puntor i thjeshte 38717

Struktura betoni m3 5 ore pune puntor i specializuar 45

F.V.Tuba te brinjezuar ml 30 ore pune puntor i specializuar

F.V.Tub çeliku fi 500 ton 30 ore pune puntor i specializuar

Ky numer puntoresh do te meret me pastrimin e kanalit ne ato segmente ku nuk eshte e mundur hyrja e makineri e konkretisht sipas zerit te preventivit. Njekohesisht do te bejne te mundur perhapjen, transportin me karro dore ne skarpate dhe bazen e kanalit.

*Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovroret, automakinistet dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kerkese eshte hartuar mbi bazen e parashikimeve te VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas te ciles, “Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që jane është/jane përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Ne rastin konkret, ne projekt-preventivin jane parashikuar punimetqë do të kryhen dhe per realizimin e tyre jane kerkuar inxhinieret sipas profileve dhe profesioneve perkatese. Numri i tyre eshte bere nisur nga sasite e punimeve ne preventive dhe natyren e objektit te kesaj kontrate.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**-NP-1 A (Punime germimi ne toke)**

**-NP -7 A (Ujesjelles kanalizime, vepra kullimi e vaditje)**

**-NS 18 A – Punime topogjeodezike**

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne klasifikimin e niveleve (germave) per punimet sipas natyrave respektive, te parashikuara ne VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Ne cdo rast, per secilen kategori licence, eshte percaktuar niveli (germa) duke u nisur nga vlera e punimeve ne parashikuara ne preventiv dhe/apo ne specifikimet teknike.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuiivalentin e saj
- OHSAS 45000 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuiivalentin e saj
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” ose ekuiivalentin e saj.

Çertifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rast bashkimi shoqerish cdo anetar i bashkimit te shoqerive duhet te zoteroje certifikatat e mesiperme ne raport me perqindjen dhe zerat e preventivit qe merr pjese.

*Argumentimi:* Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”

*Gjithashtu nënenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

**2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

<b>Makineri dhe pajisje</b>	<b>Nr.</b>	<b>Njesia</b>	<b>Gjendja</b>
Eskavator me goma	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrome me goma	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoniere	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion mbi 10 ton	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Karro dore	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc mbi 5 ton	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Saldarice	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kokore	20	cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	20	cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	10	cope	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	5	cope	Ne pronesi ose me qera

a. Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet :

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Leje transporti (lëshuar nga pushteti vendor e vlefshme)



b. Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Leje transporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës.

**Afati per realizimin e punimeve eshte 30 dite nga marrja ne dorezime sheshit te ndertimit**